


Si të veprojmë në rastin e simptomave të sëmundjes dhe ftohjes tek fëmijët e kopshteve dhe shkollave

Këshilla për prindërit (statusi: 16.09.2020)



Si të veprojmë në rastin e simptomave të sëmundjes dhe ftohjes tek fëmijët e kopshteve dhe shkollave

Këshilla për prindërit (statusi: 16.09.2020)

Të dashur prindër,

në muajt e vjeshtës dhe dimrit, tek shumica e fëmijëve dhe adoleshentëve shfaqen infeksione të rrugëve të frymëmarrjes (p.sh. kollë dhe rrufë). Ndonjëherë ankesat bëhen aq të forta, sa ndjekja e kopshtit ose shkollës bëhet e pamundur. Sidoqoftë, shumica e këtyre infeksioneve nuk janë gjithmonë serioze. Ndonjë kollë e rastit ose një rrufë e lehtë ju lejon të vazhdoni ndjekjen e institucioneve. Megjithatë, lutemi të mos harroni, se është një detyrë e përbashkët e prindërve, kopshteve dhe shkollave për të mbrojtur të gjithë fëmijët, stafin dhe familjet e tyre ndaj infeksioneve. Prandaj ju, si prindër, fëmijët tuaj si dhe punonjësit e institucioneve, duhet të jeni veçanërisht të vëmendshëm dhe të respektoni patjetër udhëzimet e higjienës. Megjithatë, përgjithësisht do të jetë gjithmonë një proces drejtpeshimi midis mbrojtjes ndaj infeksionit dhe të drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje dhe arsimim.

Nuk është e mundur të eliminohet çdo rrezik i mbetur i një infeksioni me koronavirus (Covid-19). Qëllimi ynë i përbashkët duhet të jetë ulja e nivelit të transmetimit mundësisht sa më shumë, duke respektuar patjetër masat e higjienës. Ndërsa përjashtimi i fëmijëve me simptoma të lehta sëmundjeje nuk është i dobishëm.

E rëndësishme: Siç ka qenë rregull edhe para pandemisë së koronës, fëmijët që janë dukshëm të sëmurë nuk lejohet të sillen as në kopsht, as në shkollë. Vlerësimin, nëse fëmija është i sëmurë, vazhdoni ta përcaktoni ju si prind. Këtu duhet të keni parasysh:

1. Një rrufë pa ndonjë simptomë të mëtejshme, si dhe ndonjë kollitje e rastit, gërvishtje apo gudulisje në fyt, nuk janë arsye për të mos marrë pjesë. Këta fëmijë mund të vijnë në institucion.
2. Fëmijët, tek të cilët simptoma të tilla si kollitja janë të njohura dhe është pjesë e një sëmundjeje joinfektive si p.sh. azma, gjithashtu mund të vazhdojnë të vijnë në institucion.
3. Fëmijët me simptoma të dyshimta për COVID-19 nuk lejohen të vijnë në institucion. Për këtë mjafton një nga simptomat e mëposhtme:
 - temperaturë 38 ° C e sipër,
 - kollë,
 - diarrë,
 - të vjella,
 - ndjesi e përgjithshme të sëmurë (rraskapitje, dhimbje koke),
 - çrregullime të nuhatjes ose shijes.

4. Nëse fëmija juaj ka nevojë për një mjek apo jo, këtë duhet ta gjykoni së pari ju vetë si prind. Nëse është e nevojshme, kontaktoni mjekun/mjekën tuaj të besuar ose telefononi shërbimin e gatishmërisë mjekësore 116 117.
5. Nëse një fëmijë ka një simptomë që bën të dyshosh për COVID-19, duhet të kryhet një test. Nëse një fëmijë shfaq simptoma të përgjithshme pa dyshim të qartë për COVID-19, atëherë ai duhet të rrijë të paktën dy ditë nën vëzhgim në shtëpi dhe të paktën prej 24 orësh të mos ketë patur temperaturë dhe të ndihet përgjithësisht mirë me shëndet.
6. Vëllezërit dhe motrat e shëndetshëm që nuk duhet t'i nënshtrohen karantinës mund të ndjekin institucionin, edhe nëse vëllai ose motra e tij/saj ka simptoma të lehta.
7. Në rastin e fëmijëve pa simptoma sëmundjeje, por që kanë pasur kontakt direkt me një person me një rezultat pozitiv të testit, për ata do të vendosë Zyra e Shëndetit Publik nëse lejohet ta ndjekin institucionin apo jo.

Këshillat mund të ndryshojë në varësi të zhvillimit të procesit të infeksionit dhe njohurive të reja shkencore. Ato burojnë nga data 16 shtator 2020.

Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme, mund të informoheni më shumë tek: www.coronavirus.sachsen.de